



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1066 Prot.

Tiranë, më datë 17.11.2023

VENDIM
Nr. 580, datë 17.11.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Vendimit Nr. 792, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënie, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale”, ndryshuar me Vendim Nr. 329, 02.06.2021, pas shqyrtimit më parë të kërkesës në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 17.11.2023:

VENDOSI:

- Miratimin e kërkesës së **Z. Luçjano Bojaxhiu** për pajisje me Licencë individuale në Zbatim (Z), në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale për kategorinë (A), në nënkategoritë:
 - Z/A/1. Zbatim në konservim dhe restaurim i rrënojave/ siteve arkeologjike;
 - Z/A/2. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;
 - Z/A/3. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;
 - Z/A/4. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;
 - Z/A/5. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);
 - Z/A/6. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;
 - Z/A/7. Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (trugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
- Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
- Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja e tij. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrative.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

